



Republika e Kosovë
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060-54154 dt. 15.12 2020

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 19.11.2020, ora 10:00.
Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, Gani Podrimqaku, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi. Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, Drejtori për Buxhet dhe financa Shyqyri Bublaku, Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë: Ruzhdi Lestrani dhe Drejtoresha e Drejtorisë së Ambientit dhe Planifikim Hapsinor Flutra Avdiu.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 23.10.2020.
2. Propozim Rregullorë për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.
3. Propozim Vendim për rrënimin e ish objektit të Komunës, si dhe objekteve tjera përcjellëse.
4. Propozim Vendim për bashkimin dhe parcelizimin e parcelave kadastrale.
5. Propozim Vendim për këmbimin e parcelave në zonën kadastrate Gillogoc.
6. Model Kodi i Etikës
7. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: hapi mbledhjen e KPF, pasi përshëndeti të pranishmit, prezantoi rendin e ditës .

Pasi nuk pati diskutime hodhi në votim rendin e ditës , prezent gjatë votimit ishin 7 anëtarë:

Për votuan 7 anëtar, Kundër nuk pati., Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 23.10.2020.**

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit** - hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 7 anëtarë:

Për votuan 7 anëtar, Kundër nuk pati, Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e dytë e rendit të ditës: 2 . Propozim Rregullore për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Flutura Avdiu- Asociacioni i Komunave të Kosovës përmes Kolegjiumit të Zyrtarëve ka hartuar "model-rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës", e cila rregullore plotëson ciklin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Të cilët kanë inkurajuar dhe i kanë rekomanduar Komunës së Glllogocit, të iniciojë procedurat për miratimin e kësaj model-rregulloreje dhe të veprohet konform Ligjit në miratimin e rregullores në fjalë.

Burim Bujupi- Nuk dëgjohej zeri...

Ramiz Lladrovci – Kjo nuk është temë por po jap shpjegim: Ne i kemi vendose ato pengesa për shkak se u parkojshin krejt veturat para City Grillit kundërligjshëm edhe pa përfitim kurgjo Komuna ata kanë nisur me shkuar me vetura deri te ato objektet e lojërave të femijëve e kane prishur krejt gjelbërimin dhe si rezultat i asaj i kam vendosur pengesat. City Grilli i ka 10 ari prone të Komunës që e shfrytëzon me 60^m ose 50^m lokal kështu që me dashur me i bërë pengesa ligji më lejon me i a kthyer në 60^m dhe me ja heq krejt ato dhe i beje ato pengesa por nuk i kam bërë ato pengesa por e kam bërë sepse ishin duke e prishur krejt gjelbërimin ne mes te objekteve banesore në mes te banesave dhe për këtë qëllim e kam bërë. City Grilli nuk ka bërë kurre kerkese me mbajtur parkingun aty përpara sepe ndoshta edhe ja kishem dhënë por unë e kam bërë edhe për një qëllim se qytetaret nuk mujshin me perdore trotuarin me kalu me ece si përpara qysh ka qene i lire. Tash ne jemi duke e shtruar rrugën ,kemi shpallur edhe tenderin ,kane filluar edhe punimet kështu që aty ska me mbetur parking ka me u bërë rruge dhe ka me ju shkuar shume afër krejt objekteve kështu që pronën komunale kemi me e shfrytëzu ne mënyren më të mire me qëllim që qytetaret e Drenasit me shfrytëzuar ashtu siç duhet , jo me shfrytëzuar individe privatisht për nevoja qëllime të veta. Parkingjet që janë të ndërtuara me shfrytëzim të banoreve, ato kanë qene në shfrytëzim të banoreve. Unë jam kunder atyre pengesave ku janë me qëra me i a hequr ato hekrat sepse e kanë degraduar dhe kush do që parkon në vend parking ku është i rezervuar ajo merimanga ka për obligim me i marr edhe me i hequr , kam diskutuar edhe në bord të drejtorave që me i hequr ato pengesa , përveç asaj une dyshojë që e kanë rezervuar pa pasur të paguar , i kam parë edhe ato ngjyrat e atyre vijave me ndryshe.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar, Kundër nuk pati, Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e tretë e rendit të ditës: 3. Propozim Vendim për rrënimin e ish objektit të Komunës, si dhe objekteve tjera përcjellëse.

Ramiz Lladrovci – Ne kemi edhe rekomandime edhe prej inspektoreve që ka filluar me u rreziku objekti është i ndërtuar me pllaka me drunjë nuk është me beton, kështu që objekti duhet me u rrënua sepse nuk ka asnjë mundësi me u be riparim ose me u mirëmbajta, kështu që ne e

kemi propozua përmes Kuvendit , unë mundem me përfunduar edhe pa kaluar ne Kuvend por po dua me kalua përmes Kuvendit sepse ne do te pastrojmë krejt vendin.

Burim Bujupi – Nuk dëgjohe zëri.....

Ramiz LLadrovci – Plani zhvillimorë e ka parapare se pari pronën me dhëne ne shfrytëzim edhe pjese te mëdha te saj me i pasur ne shfrytëzim për komunën , si salla e kulturës , salla te ndryshme ,objekte qe i kemi për nevoja te komunës dhe për nevoja te qytetareve e dyta me shumë i kemi vendose për shkak te objekteve te cilat janë memorialë e kam kërkuar lejen me pas edhe lejen e asamblesë e kemi kërkuar dhe e vendosim ku te doni , ato memorialët i vendosim ku te doni. Ne i vendosim me marrëveshje te Kuvendit qofte ne një kënd te sheshit qofte ku është me reprezentativ sepse ai objekt te ju a kujtoje me saktësi u nis me u be shtatorja e Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Rasim Kiqines, Bedris përmbi këta edhe shqiponjën mbrapa.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar, Kundër nuk pati, Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e katër e rendit të ditës: 4. Propozim Vendim për bashkimin dhe parcelizimin e parcelave kadastrale.

Ruzhdi Lestrani – Propozimi për këmbimin e këtyre parcelave është bërë me qëllim, të rregullimit dhe shfrytëzimit sa më të mirë të këtyre pronave dhe zgjerimin e biznesit në atë hapsirë, i paraparë sipas Planit Zhvillimor Komunal, dhe për realizimin e Planit Urbanistik të Komunës së Drenasit.

Po ashtu pronari i parcelës nr.878-6, Sami (Hysni) Bequku me anë të kërkesës nr.07-070/01-49243 datë 11.11.2020 i është drejtuar Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ku ka kërkuar që në marrëveshje me Kryetarin e Komunës të bëhet ky këmbim parcelash.

Këmbimet e këtyre parcelave janë të domosdoshme si për pronarin e kësaj prone ku me këtë këmbim do të bëhet rregullimi dhe shfrytëzimi më i mire i pronës, po ashtu edhe për Komunën do të ishte i dobishëm ky këmbim, për realizimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Urbanistik të Komunës së Drenasit.

Ekipi profesional i Drejtorisë për Gjodezi, Kadastër dhe Pronë ka dal në vendshiqim dhe ka bërë inçizimin e pjesës së ngastrave kadastrale të shënuara më lartë të cilat do të këmben, e për të cilat pjesë janë nxjerrë edhe kopjet e planit dhe certifikatat mbi të drejtat e pronës.

Të bashkangjitur e kenë edhe skicën e terenit dhe certifikatat e njësive kadastrale.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar: *Për votuan 5 anëtar, Kundër nuk pati, 2 Abstenime.*

Kaloim te pika e pestë e rendit të ditës: 5. Propozim Vendim për këmbimin e parcelave në zonën kadastrale Gllogoc.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Fjalën e merr drejtori Ruzhdi Lestrani – Me qëllim të rritjes së zhvillimit ekonomik të Komunës së Drenasit është parë e arsyeshme që të bëhet bashkimi dhe parcelizimi i këtyre parcelave të cekura më lartë.

Bashkimi dhe parcelizimi i parcelave kadastrale, bëhet duke pasur parasysh interesin ekonomik të komunës së Drenasit, Planin Zhvillimor Komunal, dhe Planin Rregullues Urban Komunal.

Andaj, duke u bazuar në nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës përcaktohet se për Rregullimin e pronës nga

komuna duhet ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, duke marr vendim Kuvendi i Komunës.
Për votuan 7 anëtar, Kundër nuk pati, Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e gjashtë e rendit të ditës: 6. Kodi i Etikës.

Ramiz Lladrovci- Ne jemi detyruar me e bere dhe me miratuar , kemi humbur pikë ne performancë për shkak qe nuk e kemi siç kemi, ne bëjmë bartjen e krejt mbeturinave, ekonomisë familjare ne kemi humbur pike se u deshtë me bë edhe një inspektor për pranim - dorëzim , nuk e kemi bere inspektorin kemi humbur pike edhe për këto , ne duhet me miratua është Kod i Etikës se si me u vesh se si me u sjell.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar, Kundër nuk pati, Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e shtatë e rendit të ditës: 7. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.

Shyqyri Bublaku – Përcaktimi i normave tatimore është obligim ligjor për çdo vit qe e bëjmë nuk dëgjohet zëri..

Burim Bujupi- Nuk dëgjohet zëri..

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar, Kundër nuk pati, Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: 8. **Të ndryshme.**

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi si të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 11: 15 min.

Drenas 19.11.2020

Procesmbajtëse:


Zahrie Podrimqaku Subashi



Kryesuesi i Kuvendit


Labinot Halilaj